**DEKLARATË KONFIDENCIALITETI**

Unë i/e nënshkruari/a ____________________________, lindur më ____________, në ________, i/e identifikuar me kartën e identitetit nr. ___________, madhor/e dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor për qëllime të ndryshme nga ai i përcaktuar në kërkesën datë ____.____.20____, drejtuar gjykatës me qëllim aksesin në dosjen gjyqësore ______________________________ dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga aksesi në këtë/këto dosje gjyqësore përveç nëse autorizohem shprehimisht me shkrim nga subjekti/et i/e të dhënave apo kjo kërkohet me ligj.

Unë jam në dijeni se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, rregullohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe se shkelja e detyrimeve që burojnë sipas dispozitave të këtij ligji është subjekt i sanksioneve të përcaktuara në të.

Unë deklaroj se do të trajtoj si konfidenciale të dhënat personale dhe do t'i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

Unë nuk do të përdor dhe/ose përhap asnjë të dhënë personale për të cilën marr dijeni gjatë aksesit në dosjen/t gjyqësore për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e deklaruara në kërkesën drejtuar gjykatës.

Detyrimet sipas kësaj deklarate kanë efekt të pacaktuar në kohë.

__________________

Emër Mbiemër, Nënshkrimi, data